

AKT THEMELIMI DHE STATUTI

I SHOQËRISË AKSIONARE

"MeBo Group" SH.A

Sot me 17.12.2024, personi i mëposhtem:

- **Z. Ilir Gashi**, shtetas Shqiptar, atesia Ramazan, i datelindjes 08.06.1992, lindur ne Kruje dhe banues ne Tirane, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i ID. J20608011P

ne cilesine e aksionarit themelues, ka vendosur te themeloje ne Shqiperi nje shoqeri aksionare te quajtur **"MeBo Group" SH.A** sipas legjislacionit tregtar Shqipar ne fuqi, me permbajtje si me poshte vijon.

Ne kete statut:

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
- "Statuti" eshte dokumenti i vetem ligjor i shoqerise ku parashikohet themelimi i saj si dhe rregullimi i hollësishëm i çështjeve të organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë se shoqerise;
- "Aksionare" jane personat, emrat e te cileve jane regjistruar ne regjistrin e aksioneve te shoqerise si zoterues te aksioneve;

KAPITULLI I

KRIJIMI; FORMA; EMËRTIMI; OBJEKTI ; KOHËZGJATJA; ZYRA QENDRORE

Neni 1: Forma Juridike, Emertimi

Shoqeria do te kete formen e nje shoqerie aksionare ne pajtim te plote me dispozitat e ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit", me emrin **"MeBo Group" SH.A**

Neni 2: Objekti

Shoqëria ka si objektiv: ofrimin e shërbimeve dixhitale për klientët individ dhe biznes, automatizimin e proceseve të përsëritura, analizimi i të dhënave për të parashikuar rreziqet dhe për të zbuluar mashtrimet dhe sulmet kibernetike duke shfrytëzuar teknologjinë e inteligjencës artificiale. Zhvillimi dhe mordenizimi i shërbimeve në fushat e financës, sigurimeve, shitjeve etj. Plotësimi i nevojave të shoqërisë për të përqafuar shërbime dixhitale lehtësisht të aksesueshme dhe në kohë reale është një realitet i pashmangshëm. Përdorimi dhe aplikimi i teknologjisë bashkëkohore sjell përmirësime të shumta në efikasitet, cilësinë e shërbimeve dhe përvojën e klientëve. Qëllimi i **"MeBo Group"** sh.a është përafrimi i standarteve dhe nevojave të tregut shqiptar në fushën e zhvillimit të inteligjencës artificiale(IA) me vendet e zhvilluara perëndimore.

Neni 3:**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise pa afat te caktuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj prane Regjistrimit Tregtar.

Neni 4:**Zyra Qendrore**

1.Zyra qendore e shoqerise eshte; Tirane, **Rruga Shyqyri Ishmi, Pallati 24, Hyrja 6, Apartamenti 104**

2.Per me teper, shoqeria mund te hape dege apo agjensi brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

KAPITULLI II**KAPITALI THEMELTAR; AKSIONET; AKSIONERËT.****Neni 5: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar fillestar**

1.Kapitali i regjistruar i shoqerise është **3.500.000 Lek** (tremilion e peseqind mije lek), i barabarte me 35 aksione me vlere nominale secila 100.000 leke.

Aksionet sa me siper jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e aksionarit themelues te shoqerise.

Nr.	Emri i Ortakeve	Aksione	Kontributi i aksionareve ne kapital (leke)	Perqindja ne kapital
1.	Ilir Gashi	35	3.500.000	100
Totali		35	3.500.000	100 %

Neni 6:**Certifikatat e aksioneve**

Secili aksionar, qe zoteron aksione, ka te drejte te perfitoje nje certifikate per te gjitha aksionet e cdo klase te zoteruara nga ai, me pagesen e nje shume qe do te percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoj me shume se nje certifikate per aksionet e zoteruara bashkerisht nga disa persona dhe dorezimi i certifikates perfaqesuesit te zoteruesve te perbashket te aksioneve do te konsiderohet si dorezim i kryer ndaj te gjithe zoteruesve te aksioneve, ne perputhje me piken 1 te nenit 121 te Ligjit nr.9901. Emrat e zoteruesve te perbashket te aksioneve do te renditen ne certifikaten e aksionit.

Neni 7:

Regjistri i aksioneve

1. Shoqëritë aksionare mbajnë një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.
2. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon.
3. Mbajtja e regjistrit të posaçëm sa me shpejt nuk cenon detyrimin e shoqërisë për njoftimin e listës së aksionarëve, në përputhje me pikën 4 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" dhe detyrimin për të regjistruar aksionet, në përputhje me dispozitat e ligjit për titujt.

Neni 8:

Kalimi me Kontrate të Aksioneve

1. Kontrata e kalimit të aksioneve bëhet me shkrim ndërmjet paleve.
2. Transferimi i aksioneve të aksionareve të shoqërisë brenda ortakerisë apo në drejtim të personave të tretë jashtë ortakerisë është i kushtëzuar në rast nga ushtrimi i të drejtës së parblerjes në favor të aksionareve ekzistues.

Aksionaret, para se t'i transferojë në çdo formë aksionet e veta një aksionari ekzistues brenda shoqërisë apo një personi të tretë jashtë saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht të gjithë aksionaret ekzistues nëse dëshirojnë të blejnë aksionet me të njëjtat kushte ekonomike si dhe në mënyrë proporcionale sipas aksioneve që zoterojnë në kapital të shoqërisë.

Në rast se të gjithë aksionaret nuk përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve nga njoftimi apo deklarojnë se nuk dëshirojnë të blejnë aksionet, aksionari është i lirë të transferoj aksionet e tij tërësisht apo pjesërisht në drejtim të personave të tretë jashtë ortakerisë.

Në rast se një pjesë e aksionareve ekzistues përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve dhe deklarojnë se dëshirojnë të blejnë aksionet, aksionari është i detyruar të transferoj aksionet e tij në drejtim të tyre në mënyrë të barabartë (dmth në rast se dy aksionar shprehin dëshirën për blerjen e aksioneve, ato do të shiten të dy aksionareve në mënyrë të barabartë, pra 50% secilit).

Neni 8/1

Kalimi i aksioneve me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

1. Nëse një aksionar vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të aksioneve, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të aksioneve, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues të të drejtave mbi aksionet e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e aksionarit të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me aksionin e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.



2. Personi që fiton të drejtën mbi një aksion si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një aksionari, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i aksionit ose të kërkojë regjistrimin e aksionit në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të aksionit. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i aksionit, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i aksionit, ai kalon aksionin në dobi të personit tjetër.

3. Personi që fiton të drejtë mbi një aksion si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një aksionari do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i aksionit, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKB.

Neni 9: Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 176 të këtij ligji, zmadhimi i kapitalit kryhet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me pikën 1 të nenit 145 të ligji nr.9901, datë 14.4.2008.

Administratorët detyrohen të njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, vendimin për zmadhimin e kapitalit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit". Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare.

2. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të ligji nr.9901, datë 14.4.2008.

Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit". Ky vendim duhet të publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

KAPITULLI III

ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë aksionare janë:



a) **Asambleja e përgjithshme e aksionareve;**

b) **Këshilli i administrimit**, si organ i vetëm administrimi, i cili ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje, të veprimtarisë së shoqërisë

c) **Administratori**

Neni 10: Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve
Te drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- j) emërimin dhe shkarkimin e administratorit të shoqërisë;
- k) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

3. Nëse shoqëria mbetet me një aksionar, atëherë aksionari i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, " Për Regjistrimin e Biznesit ", të ndryshuar. Nëse Aksionari i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë aksionari përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- ç) vendimet për investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Neni 11:

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

1. Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori te pakten dy here ne vit. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar me shkrese, me postë ose e - mail drejtuar cdo aksionari, perfshire edhe perfaqesuesin e aksioneve ne zoterim te perbashket. Njoftimi duhet te kryhet te pakten 21 dite te Plota perpara dates se caktuar per mbledhjen e asamblese se bashku me dokumentacionin bashkelidhur te rendit te dites te parashikuar ne rastin konkret. Aksionaret detyrohen ti njoftojne shoqerise cdo ndryshim te adresave apo kontakteve te tyre ne kohe reale, ne te kundert mbajne pergjegjesi per demin e shkaktuar.

2. Në rastin kur shoqëria aksionare ka shumë aksionarë, thirrja e mbledhjes së asamblesë se përgjithshme mund t'u njoftohet aksionarëve edhe nëpërmjet botimit të informacioneve si më sipër në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin.

3. Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme jane te pavlefshme si dhe vendimet e tyre nuk prodhojne efekte ligjore, duke qene akte absolutisht te pavlefshme ne rast moskryerje te sakte te njoftimit te mbledhjes nga personat perkates apo kryerje jo ne menyren e duhur te njoftimit per mbledhje, me perjashtim te rastit kur shoqeria provon se adresat e aksionareve jane dhene gabim nga vet aksionaret.

Neni 12:

Kuorumi i nevojshem

1. Në rastin e marrjes së vendimeve te zakonshme, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë dhe jane te pranishem qofte dhe nepermjet perfaqesuesve te autorizuar, aksionaret me të drejtë vote, te cilet zotërojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit te shoqerise.

2. Në rastin e marrjes së vendimeve te jashtezakonshme, qe kerkojne nje shumice të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë dhe jane te pranishem qofte dhe nepermjet perfaqesuesve te autorizuar, aksionaret me të drejtë vote, te cilet zotërojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit te shoqerise.

3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 13:**Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e Përgjithshme mund të marre vendime të jashtëzakonshme me ane të votes pro të një shumice prej 3/4 të aksionareve pjesmarres apo të autorizuar në mbledhjen e asamblese së përgjithshme rregullisht të mbledhur për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

2. Asambleja e Përgjithshme mund të marre vendime të zakonshme me anën e votes pro të shumices të aksionareve pjesmarres apo të përfaqësuar në mbledhjen e asamblese së përgjithshme, rregullisht të mbledhur, dhe vecanerisht mbi çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve;
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 14:**Përfaqësimi në asamble**

1. Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt, rrethanë apo konflikt interese të drejteperdrejte apo të terthorte, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

Neni 15:**Procesverbalet e mbledhjeve të asamblesë**

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme të aksionareve duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.
2. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen, si dhe të

aksionarëve, që janë shprehur kundër.

3. Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 16 : Emerimi i ekspertëve kontabel te autorizuar

1.Me propozim të Keshillit të Administrimit, Asambleja e Përgjithshme cakton një ose më shumë persona fizike ose një shoqëri ekspertesh kontabel te autorizuar si ekspertë kontabel te autorizuar të shoqërisë për tre vjet me radhë, në pajtim me shkronjën "9", pikë 2, nenin 135 të Ligjit. Emerimi bëhet nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme, i cili nëse miratohet, sjell emerimin e personit të propozuar si ekspert kontabel te autorizuar të Shoqërisë.

2.Gjate mandatit të tyre, ekspertët kontabel te autorizuar mund të largohen nga detyra vetëm për shkaqe të arsyeshme. Mendimet e ndryshme për metodat e kontabilitetit apo procedurat e kontrollit nuk përbejnë shkaqe të arsyeshme për largimin ekspertëve kontabel te autorizuar.

3.Personi fizik i mposhtem emërohet si Ekspert Kontabel i Autorizuar i shoqërisë për një afat 3 vjeçar:

Personi fizik (Kontabel i miratuar). **z.Shefqet Lusha**, mbajtes i id me numer F01020091H, i pajisur me NIPT nr, **K71523005F**, me license nr.458, dt.10.02.1999

KAPITULLI IV

Keshilli i Administrimit dhe Administratoret

Neni 17: Emerimi i anetareve të Keshillit të Administrimit

1.Asambleja e Përgjithshme cakton tre numër ose më shumë, por jo më shumë se 21, persona fizikë si anetare të Keshillit të Administrimit, në pajtim me shkronjën "c", pikë 2 të nenit 135 dhe pikën 2 të nenit 155 të Ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi. Anetaret e Keshillit të Administrimit mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cenuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë. Afati i emërimit të tyre është **3 vjet** me të drejtë rizgjedhjeje.

2.Shumica e anetareve të Keshillit të Administrimit do të jenë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratore, në përputhje me parashikimet e pikës 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit.

3.Personat e mëposhtem emërohen si anetare të Keshillit të Administrimit të Shoqërisë për një afat 3 vjeçar nga momenti i regjistrimit të shoqërisë pranë QKB.



1. **Z. Ilir Gashi**, shtetas Shqiptar, atesia Ramazan, amesia Vjollca i datelindjes 08.06.1992, lindur ne Kruje dhe banues ne Kruje, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i ID.nr. J20608011P
2. **Ervis Cena**, shtetas Shqiptar, atesia Sherif, amesia Gjylferie i datelindjes 22.05.1992, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i ID. nr. J20522044M
3. **Megi Gashi**, shtetase Shqiptare, atesia Veli, amesia Mereme, e datelindjes 10.06.1992 lindur ne Elbasan dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesine e plote per te vepruar, mbajtese e ID. nr. J25610095I

Neni 18: Kompetencat e Keshillit te Administrimit

1. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;

c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

f) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;

g) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emitimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

gj) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

i) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, këshilli i

administrimit duhet të thërrasë menjëherë asamblenë e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

Neni 19: Shkarkimi dhe largimi i anetareve të Këshillit të Administrimit

1. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të administrimit, me shumicë të thjeshtë votash.

2. Detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit perfundon në rast se:

- personi nuk është me anëtar i Këshillit të Administrimit në baze të dispozitave të Ligjit përfshirë nënin 157 dhe pikën 7 të nenit 158.
- personi ndodhet në gjendje paaftesie pague;
- personi vuan ose mund të vuajë nga rregullime mendore;
- personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
- ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anetareve të tjerë të Këshillit të Administrimit në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe.

3. Anëtar i këshillit të administrimit mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Anëtar i këshillit të administrimit që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e anëtarit të ri të këtij këshilli, përpara datës kur dorëheqja të hyjë në fuqi.

4. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e anëtarit të ri të këshillit të administrimit në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga anëtar i dorëhequr, atëherë administratori apo, në mungesë apo mosveprim të tij, anëtar i dorëhequr, i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, dhe Qendra Kombëtare e Biznesit regjistron largimin e anëtarit të këshillit të administrimit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", të ndryshuar.

5. Dorëheqja e anëtarit të këshillit të administrimit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që anëtar i ka ndaj saj, sipas këtij ligji."

Neni 20: Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

1. Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen të pakten dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshësinë e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit.

2. Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me kuorumin e përcaktuar në nënin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të marrin pjesë në mbledhje



nepermjet mjeteve elektronike te komunikimit perfshire komunikimin video dhe audio konference.

3. Anetaret e Keshillit te Administrimit emerone njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes, i cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Administratori nuk mund te emerohet si Kryetar i Keshillit te Administrimit. Kryetari do te drejtoje cdo takim te Keshillit te Administrimit ne te cilin ai e'shte i pranishem.

Ne rast se Kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte i pranishem brenda pese minutave nga orari i caktuar per mbledhjen, anetaret e Keshillit te Administrimit mund te emerone njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.

4. Çështjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjesemarrësve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e Kryetarit do te jete vendimtare.

5. Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e anetareve te Keshillit te Administrimit, ose komitetet e anetareve te Keshillit te Administrimit, ose nga persona te cilet veprojne si anetare te Keshillit te Administrimit, pavaresisht ne'se behet e ditur me pas se emerimi i anetarit te Keshillit te Administrimit ka pasur manges! ose keta anetare jane skualifikuar nga mbajtja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin, do te konsiderohen te vlefshme nje'lloj sikur keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdonin detyren si anetare te Keshillit te Administrimit dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.

6. Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjitha anetaret e Keshillit te Administrimit qe kane te drejte te njoftohen per mbledhjen e Keshillit te Administrimit ose te komitetit te anetareve te Keshillit te Administrimit do te konsiderohet si i vlefshem dhe i efektshem njesoj si te ishte miratuar ne mbledhjen e Keshillit te Administrimit ose ne komitetin e anetareve te Keshillit te Administrimit, te thirrur dhe mbledhur rregullisht.

Neni 21: Procesverbali i Mbledhjes se anetareve te Keshillit te Administrimit

Anetaret e Keshillit te Administrimit do te mundesojne mbajtjen e procesverbaleve te mbledhjeve ne libra te posacem per:

- a) te gjitha emerimet e kryera nga anetaret e Keshillit te Administrimit; dhe
- b) te gjitha mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme, mbledhjet e zoteruesve se aksioneve te klasave te ndryshme, dhe mbledhjet e Keshillit te Administrimit dhe komiteteve te

Keshillit te Administrimit, perfshire edhe emrat e anetareve te Keshillit te Administrimit te pranishem ne keto mbledhje.

Neni 22: Emerimi i Administratoreve

1. Keshilli i Administrimit zgjedh nje ose me shume persona fizike si Administratore dhe perfaqesues te Shoqerise per nje periudhe **3 (tre) vjeçare**, ne pajtim me nenin 158 te Ligjit nr.9901.

Emerimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te Keshillit te Administrimit, i cili, nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si Administrator. Administratoret mund te shkarkohen ne cdo kohe nga detyra, pa cenuar te drejtat



qe burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.

2. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktohen si Administratore për sa kohë që shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit përbehet nga persona të pavarur që nuk ushtrojnë kompetenca administrimi.

3. **Administrator i pare** i shoqërisë është caktuar: **Z. Ilir Gashi**, shtetas Shqiptar, atesia Ramazan, amesia Vjollca, i datelindjes 08.06.1992, lindur në Krujë dhe banues në Krujë, madhori e me zotesinë e plotë për të vepruar, mbajtes i ID. J20608011P për një afat 3 vjeçar që fillon nga momenti i depozitimit të këtij statuti në Qendren Kombëtare të Biznesit, me të drejtë rinovimi automatikisht përveçse organet kompetente vendimarrëse vendosin ndryshe.

Neni 23: Kompetencat e Administratoreve

1. Administratorët kanë të drejtë:

- a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asamblëja e përgjithshme;
 - d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
 - e) të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
 - ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Detyrat, që i cakton ligji këshillit të administrimit, nuk mund t'u delegohen administratorëve.
3. Nëse shoqëria emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët. Statuti ose rregulloret e miratuara nga këshilli i administrimit, mund të parashikojnë ndryshe.
4. Këshilli i administrimit mund t'i shkarkojë administratorët në çdo kohë.
5. Administron regjistrin e posaçem si dhe të dhënat e aksionareve.

Kreu V

Neni 24: Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria aksionare prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;



b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligji;

d) kur, si pasojë e humbjeve ushtrimore, kapitalet e veta të shoqërisë janë në vlerë më të ulët se vlera minimale e kapitalit të regjistruar, të përcaktuar sipas nenit 107, të këtij ligji, apo kur vendoset zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë nën këtë vlerë minimale dhe hyrja në fuqi e këtij zvogëlimi nuk kushtëzohet me realizimin e një zmadhimi vijues, nëpërmjet të cilit shoqëria të rikapitalizohet me kontribute të reja me vlerë, të paktën, sa vlera e nevojshme për të arritur kapitalin minimal të përcaktuar sipas atij neni;

dh) në raste të tjera, të parashikuara në statut;

e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

ë) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e aksionarëve.

Neni 25: Rezerva ligjore

1. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

2. Shoqëria llogarit e ndan dividendët, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shuma e caktuara për rezervat e përmendura me larte.

KREU VI

Neni 26: Njoftimet

1. Çdo njoftim që u jepet ose kryhet nga persona sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jete me shkrim në adresën e parashikuar në pikën 4 të kësaj Statuti.

2. Shoqëria mund t'i japë njoftim një aksionari, personalisht ose duke e dërguar me leter porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të aksionarit e cila i është njoftuar Shoqërisë nga aksionari.

Neni 27:

Te ndryshme

Ky statut perben dokumentin e vetem te shoqerise qe parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarise se shoqerise. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, aksionaret do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

Ky statut hartohet ne 4 kopje me vlere te njejte ligjore ne gjuhen Shqip dhe nenshkruhet pa verejtje nga Aksionari themelues i saj.

Ngarkohet Ilir Gashi per depozitimin e ketij statuti prane Qendres Kombetare te Biznesit.

AKSIONARI THEMELUES

Ilir Gashi

Ilir Gashi 